



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:088015
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05842977

PAKR.nr.323/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Skender Çoçaj- anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli në çështjen penale kundër të akuzuarit B.Rr, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK, e ricilësuar nga gjykata në veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.Rr, av.Ahmet Gjinovci, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan -Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.50/2022 të datës 18.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPP-se, me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.Rr, av.Ahmet Gjinovci, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.50/2022 i datës 18.04.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me datë 08.04.2019 Prokuroria Themelore në Prishtinë - DKR, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.7K/19 ndaj të akuzuarit B.Rr, për shkak të veprave penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së, dhe keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Me 16 dhjetor 2019 Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.58/19 të dt.16.12.2019, të akuzuarin B.Rr, e ka shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të përshkruar në pikën I të dispozitivit, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 1.500 euro, i cili dënim mund të zëvendësohet në dënim me burgim.

Të akuzuarit i llogaritet dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.22.02.2019 deri me dt.21.05.2019, ashtu që do i mbetet pagesë shuma prej 300 euro. Të akuzuarit i konfiskohet shuma në vlerë prej 10 euro dhe i kthehet telefoni i markës Samsung.

Ndërsa për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, të përshkruar në pikën II të dispozitivit i akuzuari është liruar nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.Rr, av.Ahmet Gjinovci, ka ushtruar ankesë ndaj aktgjyimit PKR.nr.58/19 të dt.16.12.2019, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal.

Prokuroria Themelore në Prishtinë – DKR, ka ushtruar ankesë ndaj aktgjyimit PKR.nr.58/19 të dt.16.12.2019, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe vendimit mbi sanksionin penal.

Me 24.04.2020 Gjykata e Apelit – DKR, me aktvendimin PAKR.nr.99/2020 me dt.24.04.2020, ka aprovuar ankesën e PTH - Prishtinë dhe të mbrojtësit së të akuzuarit, dhe sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i atakuar është anuluar dhe çështja është kthyer në rishqyrtim.

Me 28 tetor 2020 Gjykata Themelore në Gjilan – DKR, me aktgjykimin PKR.nr.54/2020, të akuzuarin B.Rr e ka shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 1.500 euro, të cilin dënim nëse nuk e paguan i zëvendësohet në dënim me burgim. Ndërsa për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, është liruar nga akuza.

Prokuroria Themelore në Prishtinë - DKR, ka ushtruar ankesë ndaj aktgjyimit PKR.nr.54/2020 të dt.28.10.2020, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe vendimit mbi sanksionin penal.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.Rr – av.Ahmet Gjinovci, ka ushtruar ankesë ndaj aktgjyimit PKR.nr.54/2020 të dt.28.10.2020, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës

penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal.

Më 19 mars 2021 Gjykata e Apelit – DKR, me aktvendimin PAKR.nr.34/2021, ka aprovuar ankesën e PTH-së dhe të mbrojtësit, dhe sipas detyrës zyrtare ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë, dhe çështjen e ka kthyer në gjykim dhe vendosje.

Me 06 gusht 2021 Gjykata Themelore në Gjilan – DKR ka publikuar aktgjykim PKR.nr.80/21 i shpallur me dt.30.07.2021, me të cilën i akuzuari B.Rr lirohet nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, ndërsa e ka shpallur fajtor për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KRPK-së, duke e gjykuar dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) muaj, me dënim me gjobë në shumën 500 euro, nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën, dënimi me gjobë do të i zëvendësohet në dënime burgim.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 21.02.2019 deri më dt.21.05.2019 i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim. Të akuzuarit i ndalohet ushtrimi i profesionit në institucione publike në kohëzgjatje prej 1 viti, ndërsa koha e kaluar në burg nuk i llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit. Të akuzuarit i konfiskohet telefoni i markës Samsung dhe shuma në vlerë prej 10 euro.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.Rr – av.Ahmet Gjinovci, ka ushtruar ankesë ndaj aktgjykimit PKR.nr.80/21 të dt.30.07.2021, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal.

Me datën 27 janar 2022, Gjykata e Apelit – DKR, me aktvendimin PAKR.nr.499/2021, me rastin e ankesës së mbrojtësit dhe sipas detyrës zyrtare, ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë, dhe çështjen penale e kthen në rigjykim sa i përket pikës II të dispozitivit, ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pandryshuar.

Me datën 18 prill 2023, Gjykata Themelore në Gjilan – DKR, me aktgjykimin PKR.nr.50/2022, të akuzuarin B.Rr, duke ri cilësuar kualifikimin juridik të veprës penale e ka shpall fajtor për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 2000 euro, nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën, dënimi me gjobë do të i zëvendësohet në dënim burgim.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 21.02.2019 deri me dt.21.05.2019 do të i llogaritet në dënimin e shqiptuar. Të akuzuari i ndalohet ushtrimi i profesionit në institucionet publike në kohëzgjatje prej 1 viti. Të akuzuarit i kthehet telefoni i markës Samsung, ndërsa i konfiskohet shuma prej 10 euro.

I dëmtuari A.S, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Është obliguar i akuzuari, për veprën për të cilën është shpallur fajtor, të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 100€ (njëqind) euro, si dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë) euro, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.517/2023, i datës: 05.10.2023, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit B.Rr dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtij aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dëmtuarit, avokati Ahmet Gjinovci nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nenpar.1.2 lidhur me nenin 38 par.2 të KPP-së dhe shkelje të ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ti anulon aktgjykimet e lartcekura duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPRK-së, vlerësoi se pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe konstatoi se: Kërkesa është e bazuar.

Në kërkesë pretendohet se pjesë përbërëse e kolegjit të Gjykatës së Apelit ka qenë edhe gjyqtari Zyhdi Haziri i cili si gjyqtar i gjykatës se shkallës së parë e ky gjykuar dy herë këtë çështje në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata Supreme duke vlerësuar këtë pretendim të mbrojtësit ka konstatuar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nenpar 1.2 të KPP-së dhe e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së dytë dhe e ka kthyer çështjen në rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit B.Rr, av.Ahmet Gjinovci, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.10 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.4 të KPK-së, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza, apo aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.474/2023, të dt.05.09.2023 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.Rr, av.Ahmet Gjinovci, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së, në të cilën ka prezantuar i dëmtuari A.S, i akuzuari B.Rr dhe mbrojtësi i tij me autorizim zëvendësues av.Osman Havolli, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit si dhe mbrojtësi Ahmet Gjinovci të cilet kanë qenë i njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancën. I dëmtuari A.S, ka kërkuar shpenzimet e procedurës pasi që për secilën seancë të ardhur kostoja ka qenë 15 euro dhe kompensimin e dënimit si dhe kërkoj që kjo çështje të përfundoj sa me shpejt. Mbrojtësi i të akuzuarit B.Rr, me autorizim zëvendësues av.Osman Havolli, pasi elaboroi ankesën ka propozuar që e njëjta të aprovohet ndërsa i akuzuari B.Rr, e mbështeti mbrojtësin e tij.

Gjykata e Apelit, analizoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit e të akuzuarit dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet e mbrojtësit në ankesë

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit B.Rr, av.Ahmet Gjinovci, thekson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.10 lidhur me nenin 369 par.7 të KPRK-së, për arsye se prokuroria ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarit për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 i KPRK-së, dhe keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 i KPRK-së, ndërsa Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar ka bërë ri cilësimin e veprës penale, duke e shpallur

të akuzuarin fajtor për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së, kurse i akuzuari me aktgjykime të mëhershme është liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Sipas mbrojtjes arsyetimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë është në kundërtënie me përmbajtjen e shkresave të lëndës, pasi që i akuzuari nuk ka kërkuar dhe nuk ka pranuar ndonjë shumë të parave nga i dëmtuari, ndërsa gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar nuk ka dhënë arsye konkrete dhe të qarta, se për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara në mënyrë të plotë faktet vendimtare, nuk ka vlerësuar provat domethënëse, nuk ka vërtetuar faktin se çfarë ka kërkuar i dëmtuari nga i akuzuari, çka i ka premtuar i akuzuari të dëmtuarit. Aktgjykim është i paqëndrueshëm, e sidomos tani pas ri cilësimit të veprës penale, ngase përveç që është në kundërshtim me provat materiale, gjykata e shkallës së parë ka bërë dhe tejkalimin e aktakuzës duke ndërhyrë në dispozitivin e aktakuzës, në dëm të akuzuarit.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja thekson se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë në aktgjykimin e ankimuar, pasi i akuzuari nuk ka kërkuar dhe nuk ka pranuar para nga i dëmtuari, ndërsa shuma prej 10 (dhjetë) euro e cila është objekt akuze nuk qëndron, pasi që i dëmtuari atë shumë e ka lënë mbi tavolinë me datën 12.02.2019, e të cilën i akuzuari nuk ka pasur vullnet t'i pranojë. Kjo i përngjan një makinacioni, duke u nisur nga shuma prej 20 (njëzet) euro e cila është objekt akuze.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, Gjukata e shkallës së parë vetëm citon provat e administruara, duke i përmbledhë deklaratat e dëshmitarëve, por nuk jep vlerësimin e duhur për secilën provë veç e veç, duke mos e dhënë arsyetimin e duhur se cilës provë i ka falur besimin. Sipas mbrojtjes nuk është kontestuese fakti se i akuzuari ka komunikuar me të dëmtuarin përmes rrjetit FCB, por është kontestuese fakti që gjykata nuk e sqaron qartë dhe saktë përmbajtjen e bisedave se çfarë kanë biseduar palët mes vete, jo vetëm të konstatoj se ishin dërguar foto të shkresave të ndryshme për shqyrtime gjyqësore të lëndëve përmbartimore, ftesa të shqyrtimeve gjyqësore, procesverbal mbi shqyrtimin gjyqësor të lëndëve civile, ftesa për kundërvajtje si dhe vendime Administrative.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata përshkruan deklaratat e dhëna të dëshmitarit A.S, në shqyrtimin e dt.12.07.2022, në procedurën paraprake në polici me dt.21.02.2019, në prokurori me dt.13.03.2019, dhe në shqyrtimet gjyqësore të dt.08.01.2020, 26.10.2020 dhe

28.07.2021, por e njëjta gjykatë fare nuk e jep vlerësimin se a fali apo jo besimin këtyre deklaratave.

Mbrojtja thekson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal, pasi që nuk është provuar që i akuzuari e ka kryer veprën penale me të cilën është shpallur fajtor. Për më tepër gjykata e shkallës së parë ka bërë ndërhyrje në dispozitivin e aktakuzës, duke bërë ri cilësimin e veprës penale, e cila e bënë që aktgjykimi i atakuar në aspektin juridik të jetë i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm, duke theksuar se tani i akuzuari jo vetëm që nuk e ka cilësimin e personit zyrtar, por është i suspenduar, ndërsa i dëmtuari nuk e ka pasur as nuk e ka cilësinë e të akuzuarit në këtë çështje penale.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Kolegji vlerësoi pretendimet e lartë cekura ankimore si dhe shqyrtoi shkeljet të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare, të cilat kushtëzojnë ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar. Kolegji gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësit se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.10 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit, i cili është bërë konform dispozitave të nenit 369 par.4 lidhur me nenin 364 të KPPRK, në të cilën janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen tiparet e veprës penale veprës penale të ri kualifikuar për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor me aktgjykimin e ankimuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsyet e duhura për faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 369 par.6 të KPP-së, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, gjithashtu Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon dhe kjo gjykatë.

Vlerësimi i provave është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 të KPP-së, arsyet e dhëna janë të qarta, konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga i akuzuari, i cili në mbrojtjen e tij nuk e ka mohuar faktin se është takuar me të dëmtuarin në gjykatë, dhe po ashtu e ka kontaktuar përmes telefonit dhe i ka thënë se duhet ta pinë nga një kafe, duke e lënë që të takohen në kafi terin “P...” në Podujevë, me të cilin edhe janë takuar, pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë

shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka përfundimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë, të gjitha këto e bëjnë aktgjykimin e qëndrueshëm juridikisht, ndërsa thëniet ankimore se është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë të paargumentuara.

Theksimet e mbrojtjes se gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale duke bërë dhe tejkalimin e aktakuzës duke ndërhyrë në dispozitivin e aktakuzës, në dëm të akuzuarit, janë të pa bazuara për faktin se i akuzuari akuzohet për kohën sa ka qenë person zyrtar, ndërsa fakti se tani është i suspenduar është irelevant në raport me këtë status.

Sipas këndvështrimit të Kolegjit përfundimi i gjykatës se i akuzuari ka kryer veprën penale ushtrimi i ndikimit, nuk ka tejkaluar kompetencat ligjore, pasi vepra penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK-së për të cilën ka mbetur përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare, duke i propozuar gjykatës që të shpall fajtor të akuzuarin dhe ti shqiptoj dënim sipas ligjit, është e dënueshme me gjobë dhe me dënim burgimi prej (6) muaj deri në (5) vjet. Ndërsa vepra penale nga 431 par.1 të KPRK-së ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par. 1 të KPRK-së është e dënueshme gjobë ose me burgim deri tetë (8) vjet.

Kolegji gjen se përcaktimi se cila dispozitë është më e favorshme bëhet përmes krahasimit të “ashpërsisë së dënimit”, por kjo nuk bëhet në mënyrë abstrakte, mirëpo krahasimi bëhet në relacion me rezultatin e zbatimit të këtyre dispozitave në çështjen konkrete.

Vepra penale e ricilësuar ushtrimi i ndikimit është e ndëshkuar në mënyrë alternative me gjobë ose me burgim deri në tetë (8) vjet, me që në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin me gjobë, andaj nuk mund të bëhet fjalë për shkeljen e “parimit in reformatio in peius”, me që është përcaktuar dënimi i cili është më butë dhe nga zbatimi *in concreto* rrjedhë se është më i favorshëm për të akuzuarin. Në bazë të kësaj në rastin përkatës nuk do të jetë legjitime të referohet kufirit të lartë të dënimit të marrë in abstracto.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe gjetjet e kësaj gjykate

Gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor janë vërtetuar veprimet inkriminuese të përshkruara në aktakuzë.

Deri të kjo gjendje e fakteve, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave, siç janë: deklarimi i dëshmitarëve A.S, V.Sh, S.H, G. Sh dhe Rr. P, si dhe provat materiale si; ekspertiza e celularit të akuzuarit B.Rr; ekzaminimi i bërë nga Policia e Kosovës; vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 21.02.2019; vërtetimi mbi sekuestrimin e telefonit të akuzuarit B.Rr; kartëmonedha në vlerë prej 10 euro me numër serik EB3776577498; fotoalbumi i Njësitit të Forenzikës së Policisë së Kosovës; CD-ja e rastit e krim teknikës me numër 19365 e datës 21.02.2019; raporti i oficerit i datës 21.02.2019; kërkesa për masat e fshehta të simulimit të veprës penale me numër 3-7/2019 e datës 21.02.2019; urdhëresa e gjykatës për masë të fshehtë të hetimit; aktgjykimi P.nr.247/17 i datës 15.02.2019; aktvendimi me numër P.nr. 247/17 i datës 22.06.2018; kartela e ndihmës sociale e të dëmtuarit; deklarata e të akuzuarit e dhënë në prokurori me datë 07.03.2019.

Nuk qëndron fakti se akuzuari nuk ka pranuar shumën e të hollave, bazuar në dëshminë e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit A.S, i akuzuari ka pranuar shumën e parave prej 10 euro nga i dëmtuari, po ashtu bazuar edhe në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë V.Sh, S. H, G.Sh, Rr.P është vërtetuar fakti se i akuzuari ka pranuar shumën prej 10 euro nga i dëmtuari në lokalitetin Pranvera në Podujevë e cila është vërtetuar në bazë të numrit serik.

Propozimi i mbrojtësit që të thirren në cilësinë e dëshmitarëve gjyqtarja dhe prokurorja e rastit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar një propozim të tillë, e kjo për arsye se nuk do të ndikonte asgjë në gjendjen e fakteve për të cilin është akuzuar B.Rr.

Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal

Pretendimet e mbrojtësit se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, janë të paqëndrueshme, nga fakti se është provuar përtej dyshimit të bazuar se i njëjti, me veprimet e tij ka konsumuar veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale edhe është shpallur fajtor dhe dënuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimit, andaj mbi këto arsye nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit, ndërsa në anën tjetër aktgjykimi u vlerësua në drejtim të pretendimeve tjera përkitazi me vendimin mbi dënim.

Pretendimet ankimor përkitazi me vendimin mbi dënim

Edhe pse mbrojtja cek si bazë ankimore vendim mbi dënimin, në fakt nuk i referohet fare kësaj bazë, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e shqyrtoj sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se në Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësues dhe rënduese konform dispozitës së nenit 73 KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka vlerësuar sjelljen e të akuzuarit gjatë gjithë procesit gjyqësor dhe se është baba i pesë fëmijëve, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të njëjtit në kryerjen e kësaj vepre penale, shkallën e lartë të intensitetit të rrezikimit të vlerave të mbrojtura, si dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale përkatësisht dashjes dhe paramendimit të kryerjes së kësaj vepre penale. Dukë i vlerësuar rrethanat e lartcekura të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm pjesërisht e pranon edhe kjo gjykatë, përveç shkallës së lartë të pjesëmarrjes pasi që në kryerjen e veprës penale ka vepruar si person i vetëm dhe nuk është e qartë si është konsideruar rrethanë rënduese, si dhe shkallën e lartë të intensitetit të rrezikimit të vlerave të mbrojtura që është përshkrim abstrakt, nuk shpjegohet si është manifestuar në rrethanat konkrete të rastit, megjithatë Kolegji çmon se edhe në mungesë të këtyre rrethanave nuk justifikohet shqiptimi i një dënimi më të butë, dënimi të cilën e ka përcaktuar gjykata e shkallës së parë si i tillë është proporcional, i mjaftueshëm në raport me peshën konkrete të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR 323/2024, datë 19.06.2024

Bashkëpunëtore Profesionale, Anëtarët e kolegjit,

Syzana Goxhuli

Bashkim Hyseni

Kryetar i kolegjit,

Burim Ademi

Skender Çoçaj
